# *STATUTI POLITIK I FJALËS*

## *Dispozitat themelore*

### *Neni 1*

*FJALA është parti politike e qendrës së djathtë konservatore, në shërbim të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.*

### *Neni 2*

### *Qëllimi*

*FJALA ka për qëllim zhvillimin e Kosovës në shtet të fuqishëm ekonomik ku sundon drejtësia, rendi dhe ligji, shtet të drejtë dhe të barabartë, të sigurtë dhe me perspektivë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, ku respektohen liritë dhe të drejtat e njeriut, ku respektohen liria e shprehjes dhe e mendimeve.*

*Drejtësia, siguria, rritja ekonomike dhe rritja e perspektivës, ruajtja e familjes dhe e vlerave, ngritja e arsimimit dhe e edukimit, rimëkëmbja e shëndetësisë, rinia e shëndoshë, respektimi dhe fuqizimi i gruas në shoqërinë kosovare, janë qëllime dhe parime themelore të FJALËS.*

### *Neni 3*

### *Simbolet*

*Simbolet e FJALËS do të jenë: logo, flamuri dhe emblema.*
*FJALA do të ketë vulën e saj.*

### *Neni 4*

### *Selia*

*Selia qëndrore e FJALËS do të jetë në Prishtinë.*

## *Anëtarësia dhe procedurat e anëtarësimit*

### *Neni 5*

*FJALA është e hapur për anëtarësim për çdo qytetar të Republikës së Kosovës.*

***Neni 6***

***Procedurat e anëtarësimit***

*1. Çdo qytetar me të drejtë vote në Kosovë mund të bëhet anëtar i FJALËS.*
*2. Çdo qytetar që pranon dhe përkrah Programin dhe Statutin e FJALËS mund të bëhet anëtar i FJALËS.*
*3. Anëtarësimi bëhet në mënyrë vullnetare.*
*4. Anëtarësimi bëhet me formë të shkruar në Degë apo Nëndegë.*
*5. Anëtarësimi evidentohet në Regjistrin e Degës dhe me paisjen e librezës së anëtarësisë për secilin anëtar në mënyrë individuale.*
*6. Anëtarësimi nuk do të kaloj shumën prej dymbëdhjetë (12) eurosh brenda një viti.*

***Neni 7***

***Të drejtat e anëtarëve***

*1. Çdo anëtar i FJALËS ka të drejtë të informohet dhe të merr pjesë në mënyrë barabartë në aktivitetet e FJALËS.*
*2. Çdo anëtar i FJALËS e ka të garantuar lirinë e shprehjes dhe mendimit.*
*3. Çdo anëtar i FJALËS ka të drejtë të propozoj dhe të propozohet në organet e FJALËS.*
*4. Çdo anëtar i FJALËS ka të drejtë të zgjedh dhe të zgjedhet në organet e FJALËS.*
*5. Çdo anëtar i FJALËS ka të drejtë të ankohet në organet e FJALËS.*
*6. Çdo anëtar i FJALËS ka të drejtë të largohet nga FJALA dhe nuk është i obliguar për të dhënë spjegime.*

***Neni 8***

***Përgjegjësitë e anëtarëve***

*1. Çdo anëtar i FJALËS duhet respektoj Programin dhe Statutin e FJALËS.*
*2. Çdo anëtar i FJALËS duhet të respektoj mendimin ndryshe.*
*3. Çdo anëtar i FJALËS duhet të ketë qëllim interesin e përgjithshëm të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.*
*4. Çdo anëtar i FJALËS duhet të angazhohet në rritjen dhe suksesin e FJALËS.*
*5. Çdo anëtar i FJALËS duhet të kujdeset për përfaqësim dinjitoz të FJALËS.*

***Neni 9***

***Largimi nga anëtarësia***

*1. Anëtari i FJALËS mund të largohet me vullnetin dhe kërkesën e tij.*
*2. Anëtari i FJALËS mund të largohet nëse punësohet në instituticione që e ndalojnë me ligj pjesëmarrjen në parti politike.*
*3. Nëse vdes.*
*4. Anëtari i FJALËS mund të largohet nëse kandidon në listën e ndonjë subjekti tjetër politik.*
*5. Anëtari i FJALËS mund të largohet me vendim të organit të FJALËS që ka bërë anëtarësimin e tij.*
*6. Anëtari i larguar mund të ankohet në organet qëndrore të FJALËS në afat prej 15 ditësh.*

***Organet dhe organizimi i tyre***

***Neni 10***
***Organet e FJALËS***

*1. FJALA është e organizuar në organet qëndrore dhe lokale*
*2. Organet qëndrore janë:*
*a) Kuvendi i FJALËS*
*b) Kryetari i FJALËS*
*c) Kryesia e FJALËS*
*3. Mandati i organeve qëndrore është katër (4) vjeçar.*
*4. Organet lokale janë :*
*a) Dega*
*b) Nëndega*
*5. Mandati i organeve lokale është katër (4) vjeçar.*

*6. FJALA ka dy forume me mandat katër (4) vjeçar:*
*a) Forumi i Gruas*
*b) Forumi i Rinisë*

***Neni 11***

***Kuvendi i FJALËS***

*1. Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës i FJALËS.*
*2. Kuvendi mblidhet çdo katër (4) vite kur përfundon mandatin e tij.*
*3. Kuvendin e jashtëzakonshëm mund ta thërret:*
*a) Kryetari i FJALËS*
*b) Kryesia e FJALËS*
*c) Dy të tretat ( 2/3 ) e delegatëve të FJALËS*

***Neni 12***

***Kompetencat e Kuvendit të FJALËS***

*1. Kuvendi miraton rendin e ditës.*
*2. Kuvendi miraton rregulloren e punës.*
*3. Kuvendi miraton plotësimndryshimet në Statutin e FJALËS.*
*4. Kuvendi miraton Programin e FJALËS.*
*5. Kuvendi analizon veprimtarinë dhe aktivitetet e FJALËS.*
*6. Kuvendi përcakton synimet kryesore për të ardhmen.*
*7. Kuvendi shqyrton raportin e punës dhe raportin financiar ndërmjet dy Kuvendeve.*
*8. Kuvendi zgjedh Kryetarin e FJALËS.*
*9. Kuvendi zgjedh Kryesinë e FJALËS.*
*10. Kuvendi miraton anëtarët e Komisionit Statutar të propozuar nga Kryesia e FJALËS.*
*11. Kuvendi merr vendime të tjera në pajtim me Programin dhe Statutin e FJALËS.*

***Neni 13***

***Vendimet e Kuvendit***

*1. Vendimet e Kuvendit janë të plotfuqishme me shumicë të thjeshtë të votave, 50 përqind e delegatëve plus një delegat.*
*2. Vendimet e Kuvendit merren me votim të hapur.*
*3. Zgjedhja e Kryetarit bëhet me votim të hapur.*
*4. Në rastet kur ka më shumë se një kandidat për Kryetar, votimi bëhet në mënyrë të fshehtë.*
*5. Zgjedhja e Kryesisë bëhet me votim të hapur.*

***Neni 14***

***Përbërja e Kuvendit***

*1. Të drejtë pjesëmarrjeje në Kuvend kanë delegatët nga të gjitha Degët.*
*2. Numrin e delegatëve e cakton Kryesia e FJALËS.*
*3. Degët duhet të kujdesen që përfaqësimi i delegatëve të respektoj kuotën gjinore.*

***Neni 15***

***Kryetari i FJALËS***

*1. Kryetari është udhëheqësi politik i FJALËS.*
*2. Kryetari ka rol unifikues dhe përfaqësues.*
*3. Mandati i Kryetarit është katër (4) vjeçar.*
*4. Kryetari ka të drejtë të rizgjedhjes.*

***Neni 16***
***Kompetencat e Kryetarit të FJALËS***

*1. Kryetari udhëheq dhe përfaqëson FJALËN.*
*2. Kryetari merr vendime dhe qëndrime politike në pajtim me Programin dhe Statutin e FJALËS.*
*3. Kryetari bashkërendon strategjinë dhe aktivitetet në pajtim me Programin dhe Statutin FJALËS.*
*4. Kryetari thërret dhe udhëheq mbledhjet Kryesisë dhe organeve tjera qëndrore dhe lokale të FJALËS.*

***Neni 17***
***Kryesia e FJALËS***

*1. Kryesia e FJALËS është organi më i lartë vendimmarrës dhe ekzekutiv në mes të dy Kuvendeve.*
*2. Mandati i Kryesisë së FJALËS është katër (4) vjeçar.*
*3. Zgjedhjen e Kryesisë e bën Kuvendi i FJALËS.*

***Neni 18***
***Përbërja e Kryesisë së FJALËS***

*1. Kryesia e FJALËS përbëhet nga Kryetari i FJALËS, nënkryetarët, të gjithë Kryetarët e Degëve.*
*2. Kryesia e FJALËS në përbërjen e saj ka hapësirë të merituar për gjininë femërore në pajtim me kuotën gjinore.*

***Neni 19***
***Kompetencat e Kryesisë***

*1. Kryesia merr vendime dhe qëndrime politike në pajtim me Programin dhe Statutin e FJALËS.*
*2. Kryesia bashkërendon strategjinë dhe aktivitetet në pajtim me Programin dhe Statutin e FJALËS.*
*3. Kryesia para çdo Kuvendi të rregullt apo të jashtëzakonshëm harton rregulloren e punës.*
*4. Kryesia mban mbledhje të rregullta (çdo muaj), dhe të jashtëzakonshme.*
*5. Kryesia merr vendime për pranimin e anëtarëve të ri të Kryesië.*
*6. Kryesia merr vendime për zgjedhjen e kandidatëve për Deputet në Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.*
*7. Kryesia në bashkëpunim me Kryesitë e Degëve zgjedhin kandidatët për Kryetar të Komunave në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.*
*8. Kryesia mer vendime për koalicion elektoral në Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.*

*9. Kryesia merr vendime për zgjedhjen e organeve dhe komisioneve në pajtim me Programin dhe Statutin e FJALËS.*
*10. Kryesia organizon dhe mbështet mbarëvajtjen e Kuvendeve Zgjedhore nëpër Degë .*
*11. Vendimet e Kryesisë merren me shumicë të thjeshtë të votave plus një votë.*

***Neni 20***
***Degët***

*1. Dega është organi kryesor në nivelin lokal.*
*2. Mandati i degës është katër (4) vjeçar.*
*3. Organet e Degës janë:*
*a) Kuvendi i Degës*
*b) Kryetari i Degës*
*c) Kryesia e Degës*

***Neni 21***
***Kuvendi i Degës***

*1. Kuvendi i Degës është organi më i lartë vendimmarrës i Degës.*
*2. Kuvendi i Degës mblidhet çdo katër (4) vite kur përfundon mandatin e tij.*
*3. Kuvendin e jashtëzakonshëm të Degës mund ta thërret:*
*a) Kryetari i Degës*
*b) Kryesia e Degës*
*c) Kryesia qëndrore*
*4. Kuvendin e Degës e përbëjnë delegatët nga nëndegët.*
*5. Numrin e delegatëve e cakton Kryesia e Degës me vendim të veçantë.*
*6. Kuvendi i Degës miraton rendin e ditës.*
*7. Kuvendi i Degës zhvillon punimet në pajtim me rregulloren e punës të miratuar nga Kuvendi Qëndror i FJALËS.*
*8. Kuvendi i Degës zgjedh Kryetarin e Degës.*
*9. Kuvendi zgjedh Kryesinë e Degës.*
*10. Vendimet e Kuvendit të Degës merren me votim të hapur.*
*11. Vendimet e Kuvendit janë të plotfuqishme me shumicë të thjeshtë të votave, 50 përqind e delegatëve plus një delegat.*
*12. Zgjedhja e Kryetarit të Degës bëhet me votim të hapur.*
*13. Në rastet kur ka më shumë se një kandidat për Kryetar, votimi bëhet në mënyrë të fshehtë.*
*14. Zgjedhja e Kryesisë së Degës bëhet me votim të hapur.*

***Neni 22***
***Kryetari i Degës***

*1. Kryetari i Degës është udhëheqësi politik i Degës.*
*2. Kryetari i Degës ka rol unifikues dhe përfaqësues.*

*3. Mandati i Kryetarit të Degës është katër (4) vjeçar.*
*4. Kryetari i Degës ka të drejtë të rizgjedhjes.*
*5. Kryetari i Degës udhëheq dhe përfaqëson Degën.*
*6. Kryetari i Degës merr vendime dhe qëndrime politike në pajtim me Programin dhe Statutin e FJALËS.*
*7. Kryetari i Degës bashkërendon strategjinë dhe aktivitetet në pajtim me Programin dhe Statutin FJALËS.*
*8. Kryetari i Degës thërret dhe udhëheq mbledhjet e Kuvendit të Degës, Kryesisë së Degës dhe nëndegëve të FJALËS.*
*9. Kryetari i Degës sëbashku me Kryesinë e Degës marrin vendime për themelimin e nëndegëve të reja.*
*10.Kryetari i Degës është anëtar i Kryesisë Qëndrore të FJALËS.*

***Neni 23***
***Kryesia e Degës***

*1. Kryesinë e Degës e zgjedh Kuvendi i Degës.*
*2. Mandati i Degës është katër (4) vjeçar.*
*3. Kryesia e Degës përbëhet nga Kryetari, Nënkryetarët dhe anëtarët tjerë duke respektuar kuotën gjinore.*
*4. Kryesia e Degës ka së paku trembëdhjet (13) anëtar.*
*5. Kryesia e Degës merr vendime dhe qëndrime politike në pajtim me Programin dhe Statutin e FJALËS.*
*6. Kryesia e Degës merr vendime për zgjedhjen e kandidatëve për Asamble Komunale në Zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.*
*7. Kryesia e Degës merr vendime për koalicion elektoral në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.*
*8. Kryesia e Degës bashkërendon strategjinë dhe aktivitetet në pajtim me Programin dhe Statutin e FJALËS.*
*9. Kryesia e Degës mban mbledhje të rregullta (çdo muaj) dhe të jashtëzakonshme.*
*10. Kryesia e Degës merr vendime për zgjedhjen e anëtarëve të ri të Kryesisë.*
*11. Kryesia merr vendime për themelimin e nëndegëve të reja.*
*12. Vendimet e Kryesisë së Degës merren me shumicë të thjeshtë të votave plus një votë.*

***Neni 24***
***Nëndegët***

*1. Nëndega është organi më i vogël lokal i FJALËS.*
*2. Nëndega përbëhet nga : Kuvendi, Kryetari dhe Kryesia e Nëndegës.*
*3. Nëndega ka mandat katër (4) vjeçar.*
*4.Kuvendi zgjedh Kryetarin dhe Kryesinë e Nëndegës.*
*5.Nëndega ka së paku 7 anëtar të Kryesisë së Nëdegës.*
*6.Kryetari i Nëndegës është anëtar i Kryesisë së Degës.*
*7.Nëndega zhvillon aktivitete në pajtim me Programin dhe Statutin e FJALËS.*

***Neni 25***
***Komisioni Statutar***

*1.Komisioni Statutar është organ i themeluar nga Kryesia e FJALËS.*
*2.Komisioni Statutar përbëhet nga Kryetari dhe gjashtë (6) anëtar.*
*3.Komisioni Statutar ka mandat katër (4) vjeçar,*
*4.Komisioni Statutar ka këto kompetenca:*

*a) Interpreton Statutin e FJALËS*

*b) Me kërkesë të Kryesisë inicon plotësimndryshimin e Statutit të FJALËS.*

*c) Harmonizon vendimet e FJALËS me Statutin e saj*

***Neni 26***

***Komisioni Financiar***

*1.Komisioni Financiar është organ i themeluar nga Kryesia e FJALËS.*
*2.Komisioni Financiar përbëhet nga Kryetari dhe katër (4) anëtar.*
*3.Komisioni Financiar ka mandat katër (4) vjeçar.*
*4.Komisioni Financiar ka këto kompetenca:*
*a) Kontrollon të gjitha çështjet financiare.*

*b) Ofron transparencë për të gjithë anëtarët e FJALËS.*

***Neni 27***

***Financimi i FJALËS***

*FJALA financohet nga:*

*a) Anëtarësia e FJALËS.*
*b) Donacionet nga përsonat fizik dhe juridik.*

*Donacionet dhe çështjet tjera financiare janë transparente për të gjithë anëtarët e FJALËS.*

*Në rast të pushimit apo shpërbërjes së FJALËS, së pari do të përmbushen të gjitha detyrimet eventuale dhe mjetet e mbetura eventuale do të iu kthehen donatorëve .*

***Neni 28***

***Hyrja në fuqi***

*Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i FJALËS.*